

VENDIM
Nr. 2, datë 30.11.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1, DATË 29.11.2019, TË KOMITETIT
NDËRMINISTROR TË EMERGJENCAVE CIVILE, “PËR CAKTIMIN E
DREJTUESVE QENDRORE TË OPERACIONIT PËR MENAXHIMIN E
FATKEQËSISË NATYRORE NË QARQET DURRËS DHE TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, dhe të vendimit nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë”, Komiteti Ndërmnistror i Emergjencave Civile, në zbatim të masave të marra pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore në qarkun e Durrësit, Lezhës dhe të Tiranës, i mbledhur sot më 30.11.2019,

VENDOSI:

Në vendimin nr.1, datë 29.11.2019, të Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile, të bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas emërimit “... Durrësit ...” shtohen “..., Tiranës dhe Lezhës...”.
 2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2, me këtë përmbajtje:
“2/1. Caktimin e z. Ermira Gjeçi, me detyrën e të deleguarit të KNEC-së për Qarkun Tiranë për çështjet operationale.
“2/2. Caktimin e z. Etjen Xhafaj, me detyrën e të deleguarit të KNEC-së për Qarkun Lezhë për çështjet operationale.
 3. Në pikën 3, shprehja “... Qarkun Durrës...” zëvendësohet me fjalët “... përkatësisht për qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë...”.
 4. Në pikën 4, pas referencës “2” shtohen “2/1” dhe “2/2”.
 5. Kudo në vendim fjalët “... qarkun/qet e Durrësit dhe Tiranës ...” zëvendësohen me “... qarkun/qet e Durrësit, Lezhës dhe Tiranës...”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINISTROR
I EMERGJENCAVE CIVILE**

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**